



Planuar / Doretuar Planned / Provided Received / Delivered	31.12.2021	1	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	6486/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.980/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.551/2020 të datës 16.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.572/2019 të datës 24.09.2019, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi Lagjja Bregu i Diellit, Rr." Hyzri Talla", Objekti-4, Hyrja 1, Nr.6, Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.12.2021 mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.572/2019 e datës 24.09.2019, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference SBNJD-224/19 i datës 16.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, përmes postes, me datë 20.09.2019 ka parashtruar ankesë, ndërsa është pranuar me datë 24.09.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër referencë SBNJD-224/19 të datës 16.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për shkak të shkeljeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë kuorumi për vendosje, me datë 05.11.2019, përmes shkresës me numër protokolli 5198/2019 ka njoftuar ankuesin për



pamundësinë e shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.572/2019 të datës 24.09.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në pajtim me dispozitat e LKA-së.

Pas këtij njoftimi, ankuesi ka iniciuar konfliktin administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit përmes Aktgjykimit A.nr.551/2020, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e datës 05.11.2019, dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.572/2019 të datës 24.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 572/2019, të datës 24.09.2019; Aktgjykimin A.nr.551/2020 të datës 16.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin me numër referencë SBNJD-224/19 të datës 16.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 26.06.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa të APK-së; Vërejtjen me shkrim të datës 28.05.2019; Procesverbalin e datës 15.05.2019; Urdhëresën e datës 26.03.2019; Përshkrimin e detyrave të punës; Përgjigjen në ankesë me numër protokoli 4600/2019 të datës 30.09.2019, Njoftimin e KPMSHCK të datës 05.11.2019,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e pazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, në pozitën e punës Inspektor i Pylltarisë në Sektorin e Kontrollit dhe Inspektimit të Pylltarisë.

Me datë 28.05.2019, Udhëheqësi i Sektorit të Kontrollit dhe Inspektimit të Pylltarisë, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejte me shkrim", për shkak se i njëjti ka neglizhuar detyrat e tij të punës me rastin e zbatimit të Urdhëresës DQIPGJ me numër protokoli 121/19 të datës 26.03.2019 të Drejtorit të Drejtoratit Qendror të Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë.

Kundër masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 28.05.2019, ankuesi me datë 01.07.2019 parashtron ankesë me numër protokoli SBNJH-306/2019 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit ref:SBNJD-224/19 të datës 16.07.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesin dhe ka lenë në fuqi masën disiplinore "Vërejtje me shkrim" të datës 28.05.2019.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin ref:SBNJD-224/19 të datës 16.07.2019 të KZKA-së, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për shkak të shkeljeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit shqyrtoje shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht konstatoi se ankuesi në zbatim të Urdhëresës DQIPGJ me numër protokoli 121/19 të datës 26.03.2019 të Drejtorit të Drejtoratit Qendror të Inspektoratit të



Pylltarisë dhe Gjuetisë, me datë 15.05.2019 ka bërë inspektimin të subjekti NTP "Pecaj" në Pejë, me ç' rast përmes procesverbalit me numër serik 02266 dhe 0012267, ka evidentuar se subjekti në fjalë nuk ka prezantuar dokumentacion mbi ushtrimin e kësaj veprimtarie si licencën, lejen për punë, fletë përcjellëset mbi prejardhjen e trupave teknik, dhe njëkohësisht ka obliguar Operatorit Ekonomik, që na afat prej tetë (8) ditësh të dorëzoj dokumentacionin përkatës.

Kolegji në shkresë të lëndës ka gjetur se eprori i drejtpërdrejtë i ankuesit ka deklaruar se: *Të gjitha subjektet kanë pranuar Urdhëresën DQIPGJ me numër protokollit 121/19 të datës 26.03.2019, dhe u është dhënë afat prej 15 ditësh që të dorëzojnë dokumentacionin sipas kësaj urdhëresë, dhe se inspektorët nuk është dashtë ti japin afat shtesë prej tetë (8) ditësh.* Ndërsa ankuesi në deklaratën e tij me shkrim të datës 24.05.2019, ka pohuar se gjatë kontrollit inspektues të subjekti sharrues "Pecaj" kanë ndodhur disa gabime-apo lëshime teknike por të njëjta nuk janë bërë më qëllim, por si lëshime në proces të punës, ndërsa përkitazi me aftin tetë (8) ditor për dorëzimin e dokumenteve dhe fletë përcjellësve kemi vepruar sikurse në praktiken e mëhershme dhe se përkundër faktit që është dorëzuar urdhëresa e datës 26.03.2019 por në momentin e kontrollit inspektues na ka ikur si detaj pa ndonjë qëllim.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në të gjeturat si më lartë, konstaton se ankuesi ka caktuar një afat shtesë prej tetë (8) ditësh për subjekti NTP "Pecaj" në Pejë, edhe pse sipas deklaratës se udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit ky subjekt ka qenë i njoftuar me kohë lidhur me kërkesat që dalin nga Urdhëresa DQIPGJ me numër protokollit 121/19 e datës 26.03.2019, dhe subjektet të cilave ju është drejtuar urdhëresa e kanë pasur afatin e caktuar prej 15 ditësh që të dorëzojnë dokumentacionin sipas kësaj urdhëresë. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Urdhëresën DQIPGJ me numër protokollit 121/19 të datës 26.03.2019, dhe rrjedhimisht vlerëson se udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit, dukë vepruar në pajtim me nenin 66 paragrafi 1 dhe nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.1 të Ligjit Nr.03/L149 për Shërbimin Civil, dhe me nenin 7 paragrafi 1 nën agrafi 1.2 të Rregullores 04/2011, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *1. Për shkeljet e lehta të përcaktuara me nenin 5 të kësaj Rregulloreje, mund të shqiptohen këto masa disiplinore; 1.2 Vërejtje me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuara dhe vendoset në dosjen personale të nëpunësit civil.*

Andaj, Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër reference SBNJD-224/2019 të datës 16.07.2019 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt dispozitat materiale ligjore, duke vepruar kështu në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.980/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së